



Në përputhje me nenin 10 të Ligjit nr. 05/L-057 për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) shpall si vijon:

KONKURS
për
një (1) Ekspert i Mjedisit dhe Social (EMS)

Numri i referencës: 05/2020

Konteksti

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) është subjekt i pavarur juridik i krijuar me ligjin e vet, për të ndihmuar në plotësimin e nevojës për qasje të shtuar në financa për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) në Kosovë me qëllim të krijimit të vendeve të punës, rritjes së prodhimit vendor dhe shërbimeve me vlerë të shtuar, përmirësim të bilancit tregtar dhe forcim të mundësive për financimit për NMVM.

Përshkrimi i përgjegjësisë të punës:

ESM e përkrahë FKGK në implementimin e sistemit të menaxhimit mjedisor dhe social (SMMS), dhe në implementimin e Kornizës së Menaxhimit Mjedisor dhe Social (KMMS) të Projektit për përkrahje të Fuqizimit Financiar (FSSP) të financuar nga Banka Botërore. Ai/ajo i përkrahë Institucionet Financiare Partnere të FKGK (IFP) në zhvillimin e SMMS të tyre dhe i këshillon në të gjitha fazat e implementimit të SMMS-ve përkatëse, përfshirë çdo aktivitet trajnimi/vetëdijesimi dhe koordinim në lidhje me mjedisin, sipas kërkesave të FKGK.

ESM do të punojë me Menaxherin e Lartë të Garancisë/Koordinatorin e Mjedisit të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) dhe Specialistin e Mjedisit dhe Social të Bankës Botërore (BB) dhe me donatorët tjerë ndërkombëtarë që e financojnë FKGK-në.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Shqyrton SMMS ekzistuese të FKGK-së;
- Përkrahë FKGK-në në përshtatjen dhe përmirësimin e SMMS të saj të tanishëm, sipas legjislacionit kombëtar dhe politikave të Bankës Botërore dhe kërkesave tjera të donatorëve:
 - Përgatitë doracakun për M&S: shpjegon se si menaxhimi M&S është gdhendur në proceset e kujdesit të duhur, monitorimit dhe raportimit;
 - Përgatitë shabllonet M&S: të përdoren për t'i adresuar çështjet e M&S sipas politikave dhe procedurës;
 - Propozon ndryshime/përmirësime të procedurës aktuale M&S të PMMS;
- Harton kurrikulën e trajnimit (zhvillimi i kapaciteteve dhe planit të trajnimit) për stafin e FKGK dhe për stafin e IFP;
- Organizon orientime dhe vetëdijesim mjedisor dhe social, dhe trajnime sipas nevojës për stafin e FKGK dhe IFP të bankës dhe të tjerët;
- Shqyrton SMMS ekzistuese të IFP-ve dhe propozon përmirësime ose zhvillon SMMS të re, kur duhet;
- Shqyrton kapacitetin e menaxhimit mjedisor dhe social të IFP-së para se të regjistrohen si IFP;
- Përkrahë e IFP në adaptimin dhe përmirësimin ose ndërtimin e SMMS sipas kërkesave kombëtare, të Bankës Botërore dhe donatorëve të tjerë, si dhe në adaptimin e nevojshëm sipas SMMS (Politikat e Mbrojtjes së BB) të aplikueshme për dritaren e BB;
- Shqyrton paketat e garancive të paraqitura nga IFP;
- Përgatitë raporte të auditimit mjedisor;
- Jep përkrahje për IFP-të sipas nevojës (pyetje, sqarime);
- Merr pjesë në misione të mbikëqyrjes me ekipin e BB dhe viziton përfituesit sipas nevojës;
- Përgatitë materiale për informim mjedisor dhe social sipas nevojës;
- Përkrahë FKGK në aktivitetet e monitorimit dhe raportimit;
- Çdo punë dhe detyrë tjetër siç lypet dhe kërkohet nga Drejtori Menaxhues.
- Në lidhje me FSSP, ESM i raporton Drejtorit Menaxhues të FKGK për:
 - Të siguruar se çdo nënprojekt dhe aktivitete në bazë të projektit (për të gjithë komponentët e FSSP) i nënshtrohen procesit dhe procedurave të KMMS të Projektit;
 - Ta asistuar FKGK gjatë vlerësimit mjedisor dhe social të nënprojekteve që duhet të sigurojnë respektimin e legjislacionit kombëtar dhe politikave të mbrojtjes së BB;
 - Ta asistuar Ekipin për Implementimin e Projektit (EIP) në shpalosjen e dokumenteve të kujdesit të duhur, shpërndarjen e informatave dhe raportimin pranë drejtorit të FKGK, dhe BB për aktivitetet e shpalosjes;
 - Shqyrtimin e nënprojektit, dizajnit, kostos dhe dokumenteve të ofertave për t'i përfshirë shqetësimet mjedisore dhe sociale dhe masat e përshtatshme zbutëse, dhe për harmonizimin e dokumenteve të nënprojektit/aktivitetit dhe dokumenteve mjedisore dhe sociale (relevante për kategorinë B+) siç definojnë në KMMS;
 - Siç definohet në KMMS, kryen mbikëqyrjen e implementimit të masave për zbutje dhe monitorim mjedisor në nënprojekte, duke përfshirë mbikëqyrjet në lokacion gjatë implementimit të nënprojekteve dhe aktiviteteve, si dhe shqyrtimin e raporteve të implementimit. Jep përshtypjet e veta dhe raporton për pajtueshmërinë me masat e përcaktuara në PMMS/listën kontrolluese të PMMS për FKGK dhe BB, siç përcaktohet në KMMS;
 - Përpilon raporte të kuptueshme për njerëzit jo-teknikë me qëllim të shpërndarjes efektive;
 - Ndërmerr detyra tjera, sipas kërkesave të Specialistit Mjedisor dhe Social të BB-së, ose siç udhëzohet nga Drejtori Menaxhues i FKGK, në përputhje me KMMS.

Kualifikimet:

- Titull universitar ose më lart, në shkencat e mjedisit, inxhinieri mjedisore, studime mjedisore, studime të biologjisë, kimisë ose inxhinierisë kimike ose ekuivalente;
- Minimum 3 vjet përvojë profesionale relevante në menaxhimin e mjedisit ose të ngjashme;
- Përvojë dhe njohuri/përvojë me Projektet me fonde nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare (përfshirë Projektet e Bankës Botërore) do të konsiderohen si përparësi;
- Njohuria e tregut bankar dhe financiar në Kosovë është aset.
- Njohuri të rregullimit kombëtar të mjedisit, politikat e BB për masat mbrojtëse dhe standardet e performancës së IFC.
- Përvojë në proceset e konsultimit
- Shkathtësi të mira komunikuese dhe sociale, përfshirë shkathtësi të shkëlqyera për lehtësim dhe prezantim, të shoqëruara me aftësitë e mira ndërpersonale (preferohet përvoja si trajner).
- Aftësi për të punuar nën presion dhe me disa aktivitete njëkohësisht.
- Në dispozicion për të marrë pjesë në çdo seancë trajnimi që organizohet nga grupi i Bankës Botërore, ose ndonjë donator tjetër i FKGK.
- Shkathtësi kompjuterike (Word, Excel, Access);
- I rrjedhshëm në gjuhën shqipe dhe njohuri të punës në gjuhë angleze.

Koha, kohëzgjatja dhe vendi i detyrës:

Eksperti mjedisor dhe social do të vendoset në ambientet e FKGK në Prishtinë, por duhet të jetë i gatshëm për të udhëtuar dhe mbajtur takime të shumta në tërë vendin.

ESM do të jetë punonjës me orar të plotë në FKGK. Kontrata fillestare lidhet për një (1) vit dhe mund të zgjatet për një (1) vit shtesë, bazuar në vlerësimin vjetor të performancës në punë, por nuk e tejkalon kohëzgjatjen e Projektit. Dy vitet e ardhshme derisa të përfundojë projekti, kontrata mund të zgjatet duke kaluar nga punonjës me orar të plotë në konsulent (pagesë ditore), varësisht nevojave të projektit.

Aplikimi:

Dokumentet që kërkohen për aplikim

- CV dhe shkresa e motivimit
- Diplomat, certifikatat dhe trajnimet relevante;
- Kontaktet e referencës nga ish punëdhënësit;

Të gjitha aplikacionet do të pranohen vetëm përmes emailit “recruitment@fondikgk.org” dhe në temën e emailit shkruhet: “Aplikacion nga: Emri dhe Mbiemri _ Pozita”

Konkursi është i hapur deri më **25.03.2020**, në orën **16:30**.

Vini re: Do të kontaktohen vetëm kandidatët nga lista e ngushtë!